



**VENDIM**

**Nr. 28 Datë 10.03.2011**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC DUNICE” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “g”, nenit 5 pika 1 gërma “g” dhe neneve 13 e 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.03.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Licensimin e shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**

***Nr. 28 Datë 10.03.2011***

**PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC DUNICE” SH.P.K NË**  
**AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkelqim Bozgo</b>	_____	_____